



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 910 Prot.

Tiranë, më datë 25.09.2020

VENDIM

Nr. 349, datë 24.09.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me V.K.M. Nr. 756, datë 26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.09.2020,

VENDOSI:

1. **Mos miratimin** e vazhdimit të procedurës së legalizimit për objektin “Shtesë 1 kat+1kat nën tokë”, me aplikues z. Ilir Aga, Tiranë;
  2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
  3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOELANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

